FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i lëndës | | | |
| Data e aplikimit | 10.05.2024 | | |
| Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet | **FABRIKA PËR PRODHIMIN E BAZES SË ASFALTIT "BLLOK GROUP" SH.P.K SH.P.K E VENDOSUR, ZONA KADASTRALE KERETISHTË, K. NOVOBËRDË** | | |
| Vlera financiare investuese e projektit ( ne euro) | | € | **175, 000.00** |
| Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor ( në euro) | | € | **300.00** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë, | | Po | Jo |
| | 1. Raporti i VNM-së në katër (4) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-s (pronarit të kompanisë së licencuar dhe përsonave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD). | Po | |
| | 2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartes zonale, kushtet ndertimore | Po | |
| | 3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit | Po | |
| | 4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme). | Po | |
| | 5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref | Po | |
| | 6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar | Po | |
| | 7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit**,** për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuesit për pëlqim mjedisor | Po | |
| | 8. Fatura e pagesës së tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor, sipas udhëzimit administrativ Nr.08/2015 | Po | |
| | 9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit | Po | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 11. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materje eksplozive:<br>Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejimin e vendosjes së rezervuarëve | Jo | |
| Emri dhe mbiemri i aplikuesit | **Elisa Kadriu** | | |
| Kompania | **“Bllok Group” sh.p.k** | | |
| Adresa e Kompanisë | **Strazhë, Novobërdë** | | |
| Tel, fax, E-maili | **eurokos14@live.com** | | |

# RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



## FABRIKA PËR PRODHIMIN BAZES SË ASFALTIT "BLLOK GROUP" SH.P.K E VENDOSUR NË ZONËN KADASTRALE KORETISHTË, K. NOVOBËRDË

Maj, 2024

**RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

**"Bllok Group" sh.p.k**

**FABRIKA PËR PRODHIMIN E BAZES SË ASFALTIT "BLLOK GROUP" SH.P.K SH.P.K E VENDOSUR, ZONA KADASTRALE KERETISHTË, K. NOVOBËRDË**

| | |
|---|---|
| **Aplikuesi:**<br>**"Bllok Group" sh.p.k**<br>**Elisa Kadriu**<br>*(Investitor)*<br><br>*Adresa: STRAZHË*<br>*K. NOVOBËRDË*<br>*Tel.:* 049-930-666<br>*Email:* eurokos14@live.com | **Hartuesi i raportit të VNM-së:**<br>**Dr. Sc. Pajtim Bytyçi**<br><br>Email: pajtim.bytyqi@hotmail.com<br>Tel: +383 44 766 442<br>Adresa: Prishtinë |

**Përmbajtja:**

1. HYRJE........................................................................... 6
1.5. Kuadri ligjor dhe institucional ....................................................................7
1.6. Objektivat e aktivitetit.................................................................................7
1.7. Kuadri ligjor..............................................................................................8
1.4. Metodologjia e punës .................................................................................9
1.8. Informatat themelore mbi: ..........................................................................9
1.9. Informacion mbi vendndodhjen e aktivitetit ..................................................9
1.10. Pozita gjeografike e lokacionit....................................................................9
1.11. Kompania-subjekti ekonomik aplikues.......................................................15
1.12. Prodhimi i asfaltit....................................................................................15
2. PËRSHKRIMI I MJEDISIT ..........................................................................16

2.1. Pershkrimi i mjedisit socio-ekonomik ........................................................16
2.2. Vendbanimet ...........................................................................................16
2.3. Lidhjet e Komunikacionit .........................................................................17
2.4. Rrugët nacionale .....................................................................................17
2.5. Klima......................................................................................................18
2.6. Natyra dhe biodiversiteti ...........................................................................18
2.7. Fauna - Zoodiversiteti ..............................................................................18
2.8. Flora - Fitodiversiteti ...............................................................................18
2.9. Trashëgimia Natyrore ...............................................................................20
2.10. Peizazhi ................................................................................................20
2.11. Reshjet...................................................................................................21
2.12. Erërat.....................................................................................................21
2.13. Karakteristikat pedologjike .......................................................................22
3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE MJEDISORE......................................24

3.1. Mjedisi ...................................................................................................24
3.2. Ndotja e ajrit ...........................................................................................24
3.3. Ndotja e ujit.............................................................................................24
3.4. Ndotja e tokës .........................................................................................27
3.5. Ndotja nga zhurma ...................................................................................28
3.6. Erozioni..................................................................................................29
3.7. Vërshimet................................................................................................29
3.8. Metodologjia ...........................................................................................30
3.9. Problemet mjedisore me prioritet.................................................................32
3.10. Ndikimet në ajër......................................................................................32
3.11. Ndikimet ne ajër, sipas Komunes ..............................................................32
3.12. Ndikimet në tokë......................................................................................33
3.13. Ndikimet ne Tokë, sipas Komunes .............................................................33
3.14. Ndikimet në ujë........................................................................................33
3.15. Ndikimet ne ujë, sipas Komunes ...............................................................33
3.16. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë .........................................................33
3.17. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë .....................................................34
3.18. Ndikimet nga zhurma...............................................................................34
3.19. Ndikimet nga zhurma, sipas Komunes .......................................................34
3.20. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave.................................................34
3.21. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.................................................35

4. PROCESI TEKNOLOGJIK ....................................................................36

4.1. Përshkrimi i ciklit të finalizimit të produktit prej fazës fillestare deri në përfundimin e produktit. ....................................................................36
4.2. Përshkrimi teknik i procesit teknologjik ....................................................................36
4.3. Baza e safaltit (stabilimentet e asfaltit) ....................................................................37
*4.4.* Procesi teknologjik i bazës së asfaltit me veprim ciklik ....................................................................38
4.5. Karakteristikat teknike – Specifikacioni i pajisjeve ....................................................................42
4.6. Paisjet për dozim ....................................................................43
*4.7.* Procesi i përfitimit të asfaltit ....................................................................58
4.8. Karakteristikat përberëse të lëndës së parë ....................................................................59
5. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT ....................................................................60

6.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër ....................................................................60
5.2. Masat per mbrojtje nga ndikimet e zhurmes ....................................................................62
5.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë ....................................................................63
5.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë ....................................................................66
5.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë ....................................................................67
5.6. Menaxhimi i mbeturinave ....................................................................67
5.7. Trajnimi dhe Ndergjegjesimi ....................................................................68
5.8. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore ....................................................................68
6. MONITORIMI DHE RAPORTIMI ....................................................................72

7.1. Monitorimi ....................................................................72
7.2. Raportimi ....................................................................72

**Lista e figurave:**

Figura 1. Lloji i njesisë zona kadastrale Strazhë, K.Novobërdë ....................................................................11
Figura 2. Lokacioni i kompanise "Bllok Group" sh.p.k ....................................................................12
Figura 3. Lokacioni i kompanise "Bllok Group" sh.p.k. ne raport me K.Novobërdë ....................................................................13
Figura 4. Lokacioni i kompanise "Bllok Group" sh.p.k ne raport me qendren e qytetit te Novobërdës ....................................................................13
Figura 5. Pozita gjeografike e Komunës së Novobërdës ....................................................................14
Figura 6. Pozita gjeografike e Komunës së Gjilanit që kufizohet me Novobërdën ....................................................................15
Figura 7. Infrastruktura e transportit ....................................................................18
Figura 8. Biodiversiteti në Komunën e Gjilanit dhe Novoberdës ....................................................................20
Figura 9. Trendafili i erës ne komunën e Novobërdës. ....................................................................22
Figura 10. Pedologjia ne komunen e Novobërdës ....................................................................23
Figura 11. Harta hidrologjike e komunës së Novobërdës ....................................................................26
Figura 12. Infrastruktura e kanalizimit (ujërat e zeza) ....................................................................27
Figura 13. Shkalla e erozionit në komunën e Novobërdës ....................................................................29
Figura 14. Impianti i bazës se asfaltit ....................................................................38
Figura 15. Skema parimore e bazës së asfaltit me veprim ciklik ....................................................................39
Figura 16. Tamburi rrotullues për tharje të agregatit ....................................................................40
Figura 17. Procesi i tharjes ....................................................................41

Figura 18. Seksioni në formë U me togun me tre rula të vëndosur nën këndin e pjerrtësisë $\lambda=20^0$ ... 44
Figura 19. Procesi teknologjik i fabrikës ... 47
Figura 20. Fortina dhe pajisjet për dozim ... 48
Figura 21 ... 50
Figura 22. Filteri për depluhurim ... 50
Figura 23. Pamje nga prerja e filterit për depluhurim ... 50
Figura 24. Kulla e përzierjës ... 51
Figura 25. Peshorja dhe pajisja për përzierje të bitumenit ... 52
Figura 26. Sistemi i furnizimit me material guror dhe dozimit ... 52
Figura 27. Sistemi i furnizimit me filter ... 53
Figura 28. Rezërvuaret e bitumenit i ndërtuar nga celiku St 37 me mure të dyfishta izuluar me lesh guri dhe i mveshur me llamarinë zinku ... 54
Figura 29. Elevatori me kova ... 55
Figura 30. Qendra komanduese, elektrike, dirigjuese ... 56
Figura 31. Sita ... 56

# 1. HYRJE

Kompania “Bllok Group” sh.p.k, ne kuadër të aktivitetëve të sajë ka inicuar procedurë për marrjen e Pëlqimit Mjedisor, duke angazhuar z. Pajtim Bytyçi, person fizik i licencuar me nr. të licencës 50/168/23 për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis (VNM).

Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e **Pëlqimit Mjedisor me qellim të zhvillimit të këtij aktiviteti pala ka marrur në shfrytëzim deponine ne zonën kadastrale Koretishtë, K. Novobërdë në ngastren kadastrale nr. P-72403034-01721-0 në të cilën parcelë ka në shfrytëzim 199714 $m^2$. Pëlqimi nga komuna e Novobërdës i është dhënë për montimin e e Fabrikes për prodhimin e asfaltit prej 5240$m^2$.** Me këtë synohet që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së bazës së asfaltit duke parashtruar dhe ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku do të ushtrohet kjo veprimtari. Duke analizuar karakteristikat e gjendjës ekzistuese të mjedisit në lokacionin ku do të zhvillohet ky aktivitet di dhe karakteristika e potencialeve përkatëse nga njëra anë dhe karaktersistikat inxhinieriko – teknike e këtij raporti të VNM-së, ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin “baza e asfaltit” dhe mjedisi, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në rrethin dhe regjionin më gjerë.

Nisur nga qëllimi paraprak dhe nga metodologjia e hartimit të Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis, ky raport bëhët me qëlim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nëvojshme për tu marrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvoglimin e ndikimeve gjatë fazës së procesirt teknologjik të punës për prodhimin e asfaltit. Pra këtë raport do të ofrohen informata te mjaftuëshme për zonën ku shtrihet projekti, zonën me të gjerë dhe ndikimet e këtij aktiviteti ne mjedis si dhe masat mjedisore qe ndërmerrën gjatë ngritjes këture kapacitetëve, gjatë operimit dhe pas përfundimit të aktivitetit prodhues.

Për hartimin e këtij raporti janë siguruar të dhëna nga burim të ndryshme, literatura ekzistuëse, ërb faqja e komunës në fjalë, raportet e ndryshme mbi vlerësimin e aktivitetëve të ngjajshëme dhe gjithashtu janë realizuar disa vizita në vendin ku bëhet investimi me qëllim të njohjës me zonën me të dhënat për pajisjet që janë dhënë nga vetë ivestitori, procesin teknologjik dhe infrastrukturën në lokacion.

## 1.5. Kuadri ligjor dhe institucional

Projekti ne vleresim do te jete nje aktivitet i industrise për prodhimin e asfaltit sipas kerkesave dhe ndertimi i rrugëve dhe hapësirave të ndryshme që do të punohet. Qellimi i ketij aktiviteti do te jete funksionimi pa krijuar probleme me mjedisin, per komunitetin ose minimizimin e tyre. Aktiviteti ne studimi do te merret me prodhimin e asfaltit.

Baza e asfaltit shërben për prodhimin e asfaltit i cili përdoret për dërtimin e rrugëve, paisjet e bazës se asfaltit janë të prodhuësit Gjerman "AMMAN-WIBAU" me kapacitet Q=240 t/h dhe janë demontuar nga një bazë e asfaltit në Austri.

Fabrika ne fjalë aktivitetin e ka prodhimin e bazes së asfaltit për ndërtimin e rrugëve dhe nevoja të tjera.

## 1.6. Objektivat e aktivitetit

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Shkarkimet ne ujera nga procesi teknologjik; "Bllok Group" sh.p.k
- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga procesi teknologjik;;
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugo;
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi i dyte i ketij aktiviteti do te jete gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

## 1.7.Kuadri ligjor

Gjate dhjetevjeçarit te fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore te cilat kane ardhur si rezultat i ri ndertimit te vendit nga shkatrrimet e luftes dhe zhvillimeve te fundit ne fushen e ndertimit dhe industrise. Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit te Republikes se Kosoves, ligji nr.03/L-025, Neni, 8 Shfrytëzimi i resurseve natyrore 1. Shfrytëzimi dhe mbrojtja e resurseve natyrore bëhet përmes planifikimit për ruajtjen e cilësisë dhe llojllojshmërisë së tyre, në përputhje me kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet e veçanta.

Perveç ligjit per mbrojtjen e mjedisit Republika e Kosoves ka edhe Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 08/ L-181), i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar për hartimin e këtij raporti.

Gjatë përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje te tjera relevante, si:

- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- ✓ Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- ✓ Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- ✓ Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- ✓ Ligji për Mbeturina Nr. 08/L-071
- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- ✓ Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- ✓ Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për te u pajisur me pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

### 1.4. Metodologjia e punës

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, fabrika për prodhimin e asfaltit në Koretishtë, K. Novobërdës, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

### 1.8. Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion,
- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit,
- Klima dhe të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion,
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit,
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti,
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës,
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

### 1.9. Informacion mbi vendndodhjen e aktivitetit

### 1.10. Pozita gjeografike e lokacionit

Fabrika për prodhimin e bazes asfaltit “Bllok Group” sh.p.k ndodhet në zonën kadastrale Koretishtë, K. Novobërdë në ngastren kadastrale nr. P-72403034-01721-0. Fabrika për prodhimin bazes asfaltit shtrihet ne këto pika koordinatave.

| Pikat koordinative për ngastrën kadastrale P-72403034-01721-0 ZK Koretishë KK Novobërdë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 7536917 | 4706794 | 8 | 7536990 | 4706428 |
| 2 | 7536901 | 4706753 | 9 | 7536869 | 4706516 |
| 3 | 7536862 | 4706671 | 10 | 7536773 | 4706587 |
| 4 | 7536931 | 4706609 | 11 | 7536745 | 4706659 |
| 5 | 7536988 | 4706557 | 12 | 7536779 | 4706726 |
| 6 | 7537082 | 4706473 | 13 | 7536851 | 4706775 |
| 7 | 7471692.00 | 4701397.00 | - | - | - |



**Figura 1.** Pikat koordinatave për ngastrën kadastrale P-72403034-01721-0, Koretishtë, Komuna Novobërdë




**Figura 2.** Njësia kadastrale Koretishtë, K. Novobërdë në ngastra kadastrale nr. P-72403034-01721-0

Lokacioni bënë pjese ne rajoni e Anamoraves, komunen e Artanës dhe rajoni i Gjilanit i cili kufizohet me komuant:

Komuna e kufizohet me:

- Prishtinës ne veri,
- Dardanën në lindje
- Gjilanin në jug, lindje dhe
- Lipjanin në perëndim.

Komuna e Gjilanit kufizohet me:

- Preshevën dhe Kumanovën në juglindje;

- Bujanocin në lindje;
- Kamenicën dhe Ranillugun në verilindje;
- Parteshin dhe Vitinë në jug;
- Lipjanin dhe Prishtinën në perëndim;
- Novobërdën në verilindje




**Figura 1.** Lokacioni i kompanisë "Bllok Group" sh.p.k




**Figura 2.** Lokacioni i kompanise “Bllok Group” sh.p.k. ne raport me K.Novobërdë




**Figura 3.** Lokacioni i kompanise “Bllok Group” sh.p.k ne raport me qendren e qytetit te Novobërdës

Komuna e Novobërdës ka rreth 9670 banorë,prej tyre rreth 60% janë serb,39% shqiptarë dhe 1% romë. Novobërda është Komunë me popullatë të përzier Shqiptare, Serbe, Turke dhe Rome. Në përbërje të komunës hyjnë 33 fshatra (Venbanime) me sipërfaqe pre 204km2 . Ka

pozitë të volitshme, sidomos në zhvillimin e Eko-Turizmit . Si vendbanime gjysmë të urbanizuara, janë Novobërda (Kolonia e re, Kolonia e vjetër), Bostana, Llabjani, Koretishtë, Pasjaku, Kufca dhe Stanishori ndërsa vendbanimet e tjera, janë të shkapërderdhura në vise kodrinore malore. Territori i komunës së Novobërdës, karakterizohet me reliev kodrinormalor. Lartësia mbidetare lëvizë nga 680 m. në viset më të ulta, deri te maja më e lartë e “Malit të Madh”, e një lartësie mbidetare prej 1260 m. që do të thotë se, diferenca në lartësi, është 600 m. Pjesën më të madhe të relievit, e përbëjnë kodrat e shumënumërta që, përshkojnë rrafshnaltat valëvalë. Ne afërsi të lokacioneve ku është planifikuar të ndërtohen turbinat me erë për prodhimin energjisë elektrike nuk ndodhen objekte të banimit

Objektet e banimit më të afërta nga turbinat me erë për prodhimin energjisë elektrike do të jen te larguara ne distancë mbi 500m.



**Figura 4.** Pozita gjeografike e Komunës së Novobërdës

Novobërda ka qene qendër kryesore ne atë kohe, me Fortesë të madhe mesjetare të ngritur ne maje te një vullkani të shuar në formë koni, pjesët e mbetura te se cilës mund te vizitohen edhe sot, dhe pjesa për banim qe shtrihen gjithandej.

Gjatë fillimit te shekullit 20, popullsia e Novobërdës ishte pakësuar, si pasojë e lëvizjes së shumicës së banoreve në zonat me qasje me te lehte në rrethin e Gjilanit.




**Figura 5.** Pozita gjeografike e Komunës së Gjilanit që kufizohet me Novobërdën

### 1.11. Kompania-subjekti ekonomik aplikues

Fabrika per prodhimin e asfaltit "Bllok Group" sh.p.k është nje kompani private e regjistruar prane Qendres se Regjistrimit te Bizneseve (QRBK) me me numer te biznesit nr. 810006719, dt. 16.03.2017 me pronare znj. Elisa Kadriu. Aktiviteti i kompanisë është prodhimi i bazes

asfaltit deri ne procesin perfundimtar te tyre për perdorim. Kompania “Bllok Group” sh.p.k, për prodhimin e bazes asfaltit për ndërtimin e rrugëve dhe nevoja.

## 2. PËRSHKRIMI I MJEDISIT

### 2.1. Pershkrimi i mjedisit socio-ekonomik

Kjo komunë shtrihet rreth koordinantave gjeografike: 42° 63 V dhe 21° 26 L. Novobërda apo Artana është nje komune e mesme rurale që ndodhet në Juglindje të Prishtinës. Komuna përbehet nga 24 zona kadastrale apo 33 fshatra.

### 2.2. Vendbanimet

Komuna e Novobërdës ka rreth 9670 banorë, prej tyre rreth 60% janë serb,39% shqiptarë dhe 1% romë. Novobërda është Komunë me popullatë të përzier Shqiptare, Serbe, Turke dhe Rome. Në përbërje të komunës hyjnë 33 fshatra (Venbanime) me sipërfaqe pre 204km2 . Ka pozitë të volitshme, sidomos në zhvillimin e Eko-Turizmit . Si vendbanime gjysmë të urbanizuara, janë Novobërda (Kolonia e re, Kolonia e vjetër), Bostana, Llabjani, Koretishtë, Pasjaku, Kufca dhe Stanishori ndërsa vendbanimet e tjera, janë të shkapërderdhura në vise kodrinore malore. Territori i komunës së Novobërdës, karakterizohet me reliev kodrinor-malor. Lartësia mbidetare lëvizë nga 680 m. në viset më të ulta, deri te maja më e lartë e “Malit të Madh”, e një lartësie mbidetare prej 1260 m. që do të thotë se, diferenca në lartësi, është 600 m. Pjesën më të madhe të relievit, e përbëjnë kodrat e shumënumërta që, përshkojnë rrafshnaltat valëvalë. Ne afërsi të lokacioneve ku është planifikuar të ndërtohen turbinat me erë për prodhimin energjisë elektrike nuk ndodhen objekte të banimit Objektet e banimit më të afërta nga turbinat me erë për prodhimin energjisë elektrike do të jen te larguara ne distancë mbi 500m.

### 2.3. Lidhjet e Komunikacionit

Rrjeti rrugor i Novobërdës është mirë i lidhur me qytetet më të mëdha të Kosovës perkatesisht ndodhet ne rrugen nacionale të Gjilanit. Përderisa struktura e vendbanimit në komunë është e koncentruar përreth qytetit, shumica e popullsisë kanë qasje të lehtë në një rrugë të rëndësishme. Rrugë magjistrale kalojnë dhe ka lidhje me qytetin e Kamenicë s, Gjilanit e cila me pas lidhet edhe me rrugë n magjistrale Gjilan-Prishtinë .

Pozita gjeografike që ka Komuna e Novobërdës, i mundëson atij lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit.

### 2.4. Rrugët nacionale

Lidhja e Novobërdës planifikohet përmesë rrugëve regjionale me qendrat kryesore atë të prishtinës dhe të Gjilanit qka do të thotë se planifikimet në të ardhem do të jen zgjerimi i rrugëve që lidhim me komunën e Gjilanit, Prishtinës dhe Kamenicës Dukuria e ndërtimeve ilegale në brezin rrugor është alarmuese, dhe kërkon intervenim të shpejtë të shoqërisë. Sa më vonë që të intervenohet, dëmet do të jenë më të mëdha dhe më veshtirë do të jetë të sanohen. Gjendja e rrugëve lokale është shumë e rëndë, pasi që ka shumë rrugë të pashtruara por ka edhe rrugë të shtruara me zhavorr që, nuk është arritur të asfaltohen kështu që munden të dëmtohen me kalimin e kohës. Ndërsa, sa i përketë ndërnimit të rrugëve, situata deri diku është e kënaqshme pasi që një vit më parë nga kompania për mirëmbajtjen e rrugëve, është kryer pastrimi i kanaleve afër rrugëve dhe është bërë asfaltimi i pjesëve të dëmtuara të rrugëve magjistrale dhe regjionale.




**Figura 6.** Infrastruktura e transportit

## 2.5. Klima

Në territorin e Komunës së Novobërdës, mbizotëron klimë tipike kontinentale. Megjithëse për shkak të lartësisë mbidetare, në disa pjesë të komunës kalon në klimë malore. Rrjedha e rregullt e regjimit termik, nuk varet prej lartësisë mbidetare, kështu që temperaturat janë minimale në janar, dhe maksimale në korrik e gusht. Reshjet mesatare vjetore, arrijnë në (909,8 mm. Sipas matjeve në zonën e Anamoravës, në vitin 2002, dhe 539.7 mm. Numri i ditëve me shi ( ditëve me reshje), nuk varet vetëm nga lartësia mbidetare por edhe nga pozita dhe ekspozicioni i terrenit, por sasia e reshjeve shtohet me rritjen e lartësisë mbidetare. Mundë të thuhet se, në territorin e komunës, mjaft fryjnë erërat. Më së tepërmi, fryjnë erërat nga veriperëndimi por më të fortat, janë nga juglindja. Reshjet e borës në këto vise, mundë të mbahen që nga tetori e deri në maj, ndërsa kohë e kthjellët është nga korriku deri në shtator. Në pjesët malore të Novobërdës, ku lartësit mbidetare janë mbi 1050 metra temperaturat janë më të ulëta, dhe periudha vegjetative është më e vonshme. Klima në komunën e Novobërdës

ndryshon edhe në pjesët e ndryshme të vendit, në pjesët jug-perëndimore në ekspozicionin verior të Novobërdës, kemi temperatura më të ulëta ( për 0.5 $^{0}$C) të reshura më pak, kurse në pjesën verilindore ku shtrihet pjesa afër qytetit të Gjilanit, parametrat klimatik ndryshojnë në temperatura më të larta

### 2.6. Ekosistemi, flora dhe fauna

Zona ka një peizazh të zakonshëm të një zone industriale me veprimtari te ngjashme dhe nuk ekziston ndonjë status si zonë e mbrojtur. Flora dhe Fauna përreth zonës është tipike e një zone kodrinore malore te thate me shume aktivitete industrial ku nuk mungon ndikimi antropogjen në mjedis. Me këtë zonë vërehet prania e bimëve kryesisht atyre barishtore, dhe shkurreve te tokave te thata kodrinoro-malore, nga bimesia dominojn bimet e familjes: Fabaceae, Fagaceae, Rosaceae, Poaceae etj. Llojet prezente te vrojtuar nga tereni ishin: *Quercus frainetto* L, *Quercus cerris* L, *Quercus pubescens* Willd, *Carpinus orientalis* Mill, *Cornus mas* L, C*ornus sanguinea* L, *Rubus fruticosus* L, *Rosa canina* L, *Crataegus monogyna* Jacq, *Fragaria vesca* L, *Pyrus amygdaliformis* Vill, *Trifolium pratense* L, *Ulmus campestris* L, *Euphorbia amygdaloides* L. *Euphorbia cyparissias* L, *Sanguisorba minor* Bertol, *Capsella bursa-pastoris* (L.) Medik, *Fraxinus ornus* L. Ndersa nga Fauna kemi lloje te ndryshme te zvarranikeve perfshire: *Testudo hermanni* (Gmelin, 1789), *Vipera ammodytes* (Linnaeus, 1758), *Zamenis longissimus* (Laurenti, 1768), *Lacerta muralis* (Boettger, 1893), *Lacerta viridis* (Laurenti, 1768) po ashtu ky regjion perfshin pakurrizor te ndryshem nje numer te vogel te gjitarve (*Lepus europaeus* (Pallas, 1778), *Vulpes vulpes* (Linnaeus, 1758), *Canis lupus* (Linnaeus, 1758) zogje te ndryshem etj.




**Figura 7.** Biodiversiteti në Komunën e Gjilanit dhe Novoberdës

## 2.7. Trashëgimia Natyrore

Mbrojtja e objekteve dhe zonave të trashëgimisë natyrore është në kompetencë të MMPH-së. Korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë është siguruar me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Sikurse trashëgimia kulturore ashtu edhe trashëgimia natyrore është një e mirë e përgjithshme, për tu shfrytëzuardhe ruajtur nga të gjithë, të trashëgohet nga ne dhe gjenerata eardhshme.

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë, me theks të veçantë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës dhe grupi punues për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis, kjo fushë (trashëgimin natyrore) analizuar në fazën e analizës së gjendjes, parashikohet që pjesa e hapsires pergjate rruges kryesore te mbrohet loji i drurit Mështenka e bardhe, të mbrohet dhe të konservohet.

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë, me theks të veçantë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës dhe grupi punues për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis, kjo fushë (trashëgimin natyrore) analizuar në fazën e analizës së gjendjes, parashikohet që pjesa e hapsires pergjate rruges kryesore te mbrohet loji i drurit Mështenka e bardhe, të mbrohet dhe të konservohet.

### 2.8. Reshjet

Reshjet e borës në këto vise, mundë të mbahen që nga tetori e deri në maj, ndërsa kohë e kthjellët është nga korriku deri në shtator Reshjet mesatare vjetore, arrijnë në (909,8 mm. Sipas matjeve në zonën e Anamoravës, në vitin 2002, dhe 539.7 mm, në vitin 2008 sipas Institutit Hidrometerologjik të Kosovës. Numri i ditëve me shi ( ditëve me reshje), nuk varet vetëm nga lartësia mbidetare por edhe nga pozita dhe ekspozicioni i terrenit, por sasia e reshjeve shtohet me rritjen e lartësisë mbidetare.

**Tabela 1.** Sasia e Reshjeve

| 002 | | II | II | V | | I | II | III | X | | XI | II | m.vjet . |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| max . | 1.3 | 10.2 | 13.2 | 15.0 | 21.5 | 25.6 | 27.4 | 24.8 | 20.5 | 16.4 | 11.6 | 3.6 | **15.9** |
| min. | -6.1 | -2.1 | 3.1 | 4.4 | 10.2 | 12.7 | 15.3 | 13.7 | 9.6 | 5.7 | 2.2 | 0.4 | **5.6** |
| mes. | 3.6 | 4.5 | 8.0 | 10.0 | 16.0 | 19.4 | 23.5 | 19.6 | 14.5 | 10.9 | 5.6 | 1.4 | **10.9** |
| Lagë sh % | 87 | 79 | 74 | 78 | 78 | 73 | 68 | 80 | 85 | 83 | 84 | 91 | **80** |
| Shtyp ja at | 954. 1 | 949.6 | 938. 4 | 942. 6 | 948. 5 | 950. 1 | 948. 4 | 948. 2 | 948. 6 | 948. 6 | 948.7 | 948.6 | **947.9** |
| ra/m. | 1.0 | 1.5 | 2.5 | 2.7 | 1.9 | 2.4 | 2.2 | 1.9 | 1.8 | 1.8 | 2.2 | 2.6 | **2.0** |
| **Reshj et.** | **31.6** | **38.1** | **55.7** | **56.0** | **93.9** | **23.3** | **85.4** | **113. 3** | **94.6** | **170. 0** | **32.1** | **115.8** | **909.8** |

### 2.9.Erërat

Mundë të thuhet se, në territorin e komunës, mjaft fryjnë erërat. Më së tepërmi, fryjnë erërat nga veriperëndimi por më të fortat janë nga juglindja. Reshjet e borës në këto vise, mundë të mbahen që nga tetori e deri në maj, ndërsa kohë e kthjellët është nga korriku deri në shtator




**Figura 8.** Trendafili i erës ne komunën e Novobërdës.

## 2.10. Karakteristikat pedologjike

Relievi i Anamoravës së Kosovës nga aspekti gjeografik dhe ai morfologjik veçohet me zona bregore valore me lugina lumenjsh, që me veprimin e lumenjve dhe të përrenjve është ndarë në disa pllaja të vogla ose të mëdha dhe, zona e rajonit kodrinorë- malor, që nga aspekti gjeomorfologjik, gjenetik dhe ai klimatik dallohen në mes tyre. Karakteristikat inxhiniere-gjeologjike të rajonit të Anamoravës: Rajoni i Anamoravës karakterizohet me një llojllojshmëri shumë të theksuar litostratigrafike dhe ka një përbërje të ndërlikuar tektonike të terrenit. Këtu janë të shprehura proceset e theksuara bashkëvepruese gjeologjike, të sjelljes së materialeve nga shpatina me formimin e sipërfaqeve të shpëlarjes së shpejtuar dhe të gërryerjeve, rrëkeve dhe me dukuri të shumta të rrëshqitjeve dhe të shembjeve të dheut, të bartjes së materialeve sterile etj.




**Figura 9.** Pedologjia ne komunen e Novobërdës

# 3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE MJEDISORE

## 3.1. Mjedisi

Ndotja e mjedisit në tërë territorin e Kosovës është një problem mjaft serioz dhe është prezent pothuaj kudo. Po ashtu edhe në komunën e Novobërdës kjo çështje është evidente. Ndotja më e madhe bëhet me lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj, dhe hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh. Në përputhje me Planet Zhvillimore Komunale, ekziston mundësia e krijimit të kapaciteteve të nevojshme të cilat minimizojnë gjasën e shkaktimit të fatkeqësive, si dhe krijojnë hapësira dhe kushte për intervenim adekuat të njësive emergjente. Komuna ka për obligim që në të ardhmen të krijoj kapacitete të mjaftueshme për parandalim, reagim dhe rikuperim në rast të fatkeqësive në përputhje me Planin e Vlerësimit të Rrezikut dhe Planin e Reagimit Emergjent. Sfidë e institucioneve të reagimit emergjent, dhe institucioneve tjera që ndërlidhen me planifikimin zhvillimor të komunës, mbetet krijimi i kapaciteteve për parandalim, intervenim, dhe sanim të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

## 3.2. Ndotja e ajrit

Në komunë të Novobërdës dhe ne rejonin e Gjilanit, ekziston vetëm një matës të ndotjes së ajrit. Ajri është më i ndotur në qendrën urbane, ndotje që shkaktohet nga pluhuri, si pasojë e djegies industriale dhe trafiku (gazrat e liruara nga makinat e vjetra dhe pa katalizator). Ndotja e ajrit shkaktohet nga përdorimi i lëndeve të ndryshme djegëse.

## 3.3. Ndotja e ujit

Vendbanimet pa qasje në sistemin e ujësjellësit, sigurojnë ujin e pijes nga puset individuale apo kolektive, të cilat shpesh nuk mirëmbahen si duhet. Këto puse nuk janë të ndërtuara si duhet dhe ndodh të ndoten nga ujërat sipërfaqësorë (si ujëra të zeza apo të kulluara) gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e popullatës.

Dihet se komuna e Novobërdës dhe rajoni i Gjilanit nuk posedon as një impiant për trajtimin e ujërave të zeza. Ekzistojnë disa gropa septike në vendbanime trajtojnë pjesërisht ujrat e zeza. Pjesa tjetër e ujrave të ndotura derdhen në lumenj dhe përroska ku ndjeshmëria e ujërave nëntokësore dhe mbi tokësore është e nivelit më të lartë. Liqenjët, lumenjtë dhe rrjedhjet tjera ndoten nga hudhja e mbeturinave.

Analiza e gjendjes në komunë sa i përket infrastrukturës së ujrave të zeza dhe atmosferike, është bërë nga ekipi i planifikimit dhe parashikohet që në të ardhmen të kemi: sisteme të ndara të ujrave fekale dhe atmosferike, në të gjitha pjesët e vendbanimit te Novobërdës dhe vendbanimeve tjera ; Planifikimi i funksionalizimit të disa segmenteve me rrjet të vjetër, me profil jo adekuat ose për nevoja më të gjera në vendbanimit. Rrjeti, duhet të bëhet edhe në pjesët e planifikuara urbane për zgjrim; Planifikimi i lidhjeve të rrjetit gjatë hartimit të projekteve kryesore të largimit të ujërave të zeza në nivel të vendbanimit, në harmoni me kolektorin kryesor (siç shihet në hartën"Kanalizimi dhe Kanalizimi Atmosferik"); Planifikim dhe ndërtimi i kolektorëve kryesor të kanalizimit, të cilët do të lidhen me kolektorin kryesorë të planifikuar të nivelit komunal. Në planin afatgjatë, në Kosovë parashihen që të ndërtohen 7 impiante për trajtimin e ujërave të zeza. Në secilin rajon, nga një. Kështu që për rajonin e Gjilanit, në të cilin bënë pjesë komuna e Novobërdës, parashihet ndërtimi i impiantit në Kamenicë. Në këtë impiant, do të shkarkoheshin ujërat e zeza të Gjilanit, Novobërdës, dhe Kamenicës. Mirëpo, derisa të gjendet mjetet për ndërtimin e këtyre impianteve, në planin afatshkurta do të duhet që secili vendbanim të ndërton impiantin e vetë ose një gropë septike për një trajtim minimal të ujit të përdorur edhe lokacioni i tij të jetë i përshtatshëm që në ta ardhëm ujërat që shkarkohen në te të mund të vazhdojnë deri në kolektorin kryesor që i transporton ato drejtë në impiantin kryesor rajonal.




**Figura 10.** Harta hidrologjike e komunës së Novobërdës




**Figura 11.** Infrastruktura e kanalizimit (ujërat e zeza)

### 3.4. Ndotja e tokës

Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjellë deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuaredhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Çdo ngjarje, veprim që prish veçoritë dhe cilësitë natyrore të kësaj hapësire jetike emërtohet ndotje e tokës. Nga ndotja e tokës në mënyrë të drejpërdrejtë ose të tërthortë preken të gjitha gjallesat. Shumica e faktorëve që krijojnë ndotjen e tokës vijnë nga shkaqe njerëzore, ku ndër më kryesoret janë: Deponimi apo hudhja në natyrë e mbeturinave shtëpiake dhe mbetjeve industriale, gazrat e shkarkuara, pesticidet dhe

plehrat kimike apo përdorimi i tepruar i tyre në bujqësi, erozionet që vijnë nga shkatërrimi i pyjeve sidomos në zonën e pyjeve të Karadakut. Në përgjithësi, rreth 20% e popullatës në vendbanimin e Novobërdës merren me bujqësi, dhe një pjesë e vogël e popullatës jeton në mërgim, ku edhe krijon të hyra të mjaftueshme për disa familje. Tokat pjellore shtrihen rreth përrockave, dhe kryesishtë shfrytëzohen për bujqësi, me një trend të rritjes së shëndërrimit të tokave pjellore në ato ndërtimore dhe sipërfaqe të pambjellura (djerrina). Në këtë aspekt, mungojnë hulumtimet përkatëse për kualitetin dhe shfrytëzimin e tyre.

Ndotja e tokës prishë ekuilibrin e lëndëve ushqyese që përmbanë toka. Lëndët e ngurta artificiale akumulohen në tokë dhe ndryshojnë veçoritë e saj fizike. Mbetjet kimike përzihen me bimët e kultivuara në tokë dhe ndikojnë negativisht në veçoritë biologjike të këtyre bimëve. Metalet e rënda, gazrat dhe mbetjet e tjera që grumbullohen në tokë prishin zhvillimin dhe cilësinë e bimëve. Këto ndryshime negative që ndodhin në tokë, ndjekin zinxhirin ushqyes dhe përcillen deri tek bimët, kafshët dhe njerëzit.

### 3.5. Ndotja nga zhurma

Në Komunën e Novobërdës por edhe ne Rajonin e Gjilanit burim kryesor i zhurmës është komunikacioni, Industria e cila zhvillohet në mënyrë të shpërndarë brenda vendbanimeve, gurëthyesit të cilët zhvillojnë një bezdisje të vazhdueshme. Ndërsa si zhurma tjera të cilat zhvillohen nga pakujdesia e të cilat janë akute zhvillohen në gjitha pjesët e komunës duke e prishur rendin dhe qetësinë publike. Në mënyrë që vendbanimit të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar, është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave,mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj.

### 3.6. Erozioni

Territori i komunës së Novobërdës, karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit të dobët, përfshijnë sipërfaqen rreth rreth 9% të territorit. Erozioni i mesëm: 38%. Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Novobërdës, përfshijnë: 15 %. Erozioni shumë i fortë: 38 %., dhe erozioni shumë i dobët: 2%.




**Figura 12.** Shkalla e erozionit në komunën e Novobërdës

### 3.7.Vërshimet

Vërshimet janë një ndër fenomenet të cilët më së shpeshti e atakojnë komunën që ndodhin në përmasa të ndryshme varësisht nga të reshurat atmosferike. Duke marr parasysh katërvjeçarin e fundit, mund të konstatojmë se përkundër të reshurave të shumta, dëmet në territorin e komunës janë më të vogla. Marrë në tërësi, dukeu bazuar në vlerësime të dëmeve pas ndodhjes së vërshimeve, këto trendë, janë në rënie, si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës përkatëse.

# 4. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE MJEDISORE PRIORITARE

## 3.8. Metodologjia

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarise, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Ky raport hartohet mbi bazen e mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendimmarrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvilohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit;
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake;
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore;
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimi;
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit;
- Parimi "Ndotësi paguan";
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut;
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtudhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Perpunim i produkteve te vajit ushqimor Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit;
- Mbrojtja e ujërave;
- Mbrojtja e tokës;
- Mbrojtja e natyrës;
- Ndryshimet klimatike;

Ndikimet kryesore ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti konsiston ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Ndikim ne peizazhin e zonës;
- Emetimet ne ajer (gaze, grimca, aroma);
- Zhurmat dhe vibrimet;
- Shkarkimet e lengeta;
- Ndikimi ne flore/ faune;
- Mbetjet e gjeneruara dhe menaxhimi i tyre;
- Ndikime socio-ekonomike;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor.

Problemet mjedisore me prioritet grupit punues për hartimin e Rapotit te vlersimit ne mjedisi, janë të harmonizuara me rezultatet e hulumtimit të opinionit publik për gjendjen mjedisore te Komunës së Novobërdës, duke u bazuar në prioritet sipas fushave dhe në vijim mund të gjeni renditjen e tyre:

<u>Fushat:</u>

*1.Uji;*

*2.Toka;*

*3.Ajri;*

*4.Biodiversitet.*

### 3.9. Problemet mjedisore me prioritet

1. *Mungesa e furnizimit me ujë të pijes, cilesia e ujit si dhe mungesa e trajtimit të ujërave të zeza;*
2. *Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;*
3. *Menaxhimi i adekuat i mbeturinave komunale;*
4. *Degradimi i tokës bujqësore, pyjeve dhe tokave pyjore dhe zhvillimi i turizmit*
5. *Planifikimi urban, gjelbërimi publik dhe zonat rekrativo-sportive dhe;*
6. *Ndotja e ajrit;*
7. *Zhurma;*

Investimi në ndërtimin dhe funksionalizimin e fabrikës për prodhimin e bazes asfaltit për ndërtimin e rrugëve "Bllok Group" sh.p.k, paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për ofrimin e shërbimit të këtij produkti si dhe për mundësitë e punësimit te qytetarve duke kontribuar ne situatën socio-ekonomike.

Ndikimet (presioni) në mjedis vinë në shprehje kur vepron faktori antropogjen në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse qe do të përdoren për te eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin ideor të konceptuar e të diskutuar më lartë në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën - parcelën ku është duke funksionuar fabrika për ne fjalë. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

### 3.10. Ndikimet në ajër

Duke e pas parasysh aktivitetin i cili zhvillohet ne këtë fabrikë ku bëhet prodhimi i bazes se asfaltit cili nevoitet për ndërtimin e rrugëve në bazë të sistemit të krijuar nuk mund te ketë ndikime negative ne ajër pasi kompoania ka vendosur sistemin e filtrave brenda standardeve ne fabrikë. Duke u bazuar në lokacionin ku është e ndërtuar fabrika ne fjalë nuk priten të tejkalohen vlerat kufitare të kualitetit të ajrit sipas të OBSH ( ky lokalitet apo tëre ky regjion

ne aspektin e cilësisë se ajrit qëndron mjaft mire). Nuk priten përkeqësime lokale në cilësinë e ajrit në kuadër të lokalitetit të drejtpërdrejtë në fushën e veprimtarisë të Fabrikës. Një ndotje e ajrit mund te vije nga procesi i punimit të motorrave te makinave që shfrtëzojnë lëndë djegëse fosile. Ndërsa nuk parasheh ndonjë proces teknologjik të përpunimit të produkteve industriale tjetër dhe realisht nuk paraqet potencial për ndikime në kualitetin e ajrit, prandaj është e nevojshme qe kjo sipërfaqe e tokës te mirëmbahet.

### 3.11. Ndikimet në tokë

Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë fabrikë, nuk do te kenë ndikim të theksuar për arsye se i gjithë aktiviteti i punës që do të kryhet do t'i kushtohet një kujdës të vëçantë sa i përkekë aspëktit mjedisorë. Lenda e pare per prodhimin bazes se asfaltit do të mënaxhohet në mënyrën me të duhur që të ruhet mjedisi. Keto lëndë ruhen sipas tandardeve dhe ne vende te pershtëasheme te izoluara dhe ne kushte klimatike te favorshme sipas rekomandimeve te prodhuesit.

Për shkak të aktivitëtit të punës së fabrikës gjatë punës se procesit teknologjik nuk do të këtë shkarkime të ujerave, përveq që do të shfrytëzohen për ujitje-sperkatje të hapësirës përreth.

### 3.12. Ndikimet në ujë

Për shkak të aktivitëtit të punës së fabrikës gjatë punës se procesit teknologjik i cili nuk do të këtë shkarkime të ujerave, përveq që do të shfrytëzohen për ujitje-sperkatje të hapësirës përreth dhe duke pasur parasysh aktivitetin e punës të kësaj fabrikë "Bllok Group" sh.p.k izolimin e kryer nga ambientet e punës duhet t;i kushtojmë rëndësi të madhë në aspëktin e ujërave duke bërë menaxhimin sa me të mirë në ambientin ku do të punohet.

### 3.13. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Në këto zona rriten llojet me të zakonshme të florës dhe faunës. Në këtë zone nuk ka llojet e mbrojtura të florës dhe faunës. Zona përreth ku është duke ushtruar aktivitetin e vetë fabrika për prodhimin bazes se asfaltit "Bllok Group" sh.p.k, është zone jo shumë e banuar ne një distancë te madhe ne perimetër, andej nuk do të ketë ndonjë ndikim te madh. Gjithashtu, në këtë lokacion e as në zonën më gjerë deri më tani nuk është evidentuar ndonjë habitat i veçantë i llojeve te botës bimore apo shtazore. Megjitheate ky aktivitet nuk paraqet ndonjë rrezik specifik në florë dhe faunë.

### 3.14. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

-Hapësira ku gjendet fabrika i lartpërmendur nuk ka ndikim negativ në popullatën e zonës. Pasi që lokacioni ku është duke ushtruar veprimtarinë e vetë fabrika për prodhimin e bazes se asfaltit "Bllok Group" sh.p.k ketë lokacion nuk krijon shqetësim për banorët lokal. Në të kundërtën, ka ndikim Pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal, njëkohësisht sjell njërën nder elementet kryesore për ngrohje si produkt i pritshëm për mjedisin që na rrethon.

### 3.15. Ndikimet nga zhurma

Nga procesi i punës ne prodhimin-mund te prodhohet një nivel mbi mesataren zhurme. Masat e rekomanduara për te parandaluar, minimizuar dhe kontrolluar dëmtimet për shkak te zhurmës:

- Izolimi i makinerive dhe pajisjeve me materiale izolimi te larta për te reduktuar zhurmat ne mjediset e punës;
- Mirëmbajtjes se rregullt duke përfshire mbushjen me ujë te makinerive, mirëmbajtje të paisjeve here pas here dhe ndrrimi apo mirëmbajtja e filtrave;
- Marrjen e te gjitha masave per parandalimin e zhurmes si makinerit levizese-transportuese, etj.

### 3.16. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Në komunën e Novoberdës mebturina menaxhon kompania regjionale Eko-Higjiena është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave.

Eko–Higjiena është kompania e parë edhe e vetme në Kosovë në fushën e pastrimit, e cila është themeluar sipas marrëveshjes së Partneritetit Publiko-Privat dhe kryen shërbimet e pastrimit me një shtrirje gjeografike në territorin e Regjionit të Gjilanit. Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e klientelës komunale është punuar në dy ndërrime ose është punuar ditën e shtunë dhe të diele. Është shfrytëzuar një automjet nga njësitë tjera punuese për të mbuluar kërkesat e klientelës.

Në venbanimet rurale-fshatra, mbeturinat grumbullohen një herë në javë, ndersa ne Novobërdë në qendër çdo ditë, zakonisht në kontejnerë me kapacitet prej 1.1 $m^3$. Mbeturinat nga komuna e Novobërdës grumbullohen në kuadër të deponisë regjionale në Velekincë i ndërtuar në vitin 2006 me sipërfaqe prej mbi 12 ha. Kjo deponi është e hapur, mbeturinat nuk klasifikohen dhe nuk menaxhohet nga KMDK.

Deponia  ka nevojë për permirësime urgjente, p.sh. trajtimin e rrjedhjeve dhe zgjerimin e saj. Marrë parasysh që kjo deponi është regjionale,  jetëgjatësia e kësaj deponie parashikohet të jetë maksimum deri në vitin 2024. Në territor të komunës së Novobërdës ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i deponive ilegale.

### 3.17. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

-Aksidentet e mundshme që mund te ndodhin gjatë aktiviteteve të fabrikës për prodhimin e bazes se asfaltit për ndërtimin e rrugëve “Bllok Group” sh.p.k, vlerësohen si raste të izoluara.

Nuk ka aktivitet me materie të rrezikshme të cilat paraqesin potencial të lartë për rrezikimin e shëndetit të njeriut apo mjedisit në përgjithësi.

# 4. PROCESI TEKNOLOGJIK

## 4.1. Përshkrimi i ciklit të finalizimit të produktit prej fazës fillestare deri në përfundimin e produktit.

“Bllok Group” sh.p.k është kompani që merret me prodhimin e bazes se asfaltit për ndërtimin e rrugëve.

Në kuadër të saj bënë pjesë:

- Prodhimi i bazes se asfaltit për ndërtimin e rrugëve

4.2. Përshkrimi teknik i procesit teknologjik

Projekti teknologjik përfshinë të gjitha paisjet makinerike të bazës së asfaltit prej fortinave të rërës dhe zhavorit deri tek silosët e prodhimit të gatshëm – asfaltit:

- Fortinat e rërës dhe zhavorit
- Pajisjet për paradoizmin e materialit,
- Pajisjet për transportimin e materialit guror nga fortinat deri te paisja për tharjen dhe nxehjen e tyre,
- Pajisjet për nxehjen dhe tharjen e materialit,
- Pajisjet deponimin e vajit për djegie – mazutit,
- Pajisjet për thithjen e pluhurit me anë të filtrave
- Pajisjet për transportimin e materialit të nxehtë deri te sita – transporteri me cikrik (kova),
- Pajisjet për sitjen dhe deponimin e materialit të nxehtë,
- Pajisjet për deponimin dhe transportimin e mbushësit – filterit,
- Pajisjet për matjen e komponenteve të vecanta – peshoret automatike,
- Pajisjet për përzierje – mikseri,
- Pajisjet për deponim – silosët e materialit të gatshëm,
- Pajisjet për deponimin dhe ngrohjen e bitumenit,
- Pajisjet për komandim dhe sinjalizim, si dhe
- Furnizimi me energji elektrike – trafo-stacioni i energjisë elektrike.

### 4.3. Baza e safaltit (stabilimentet e asfaltit)

Gjatë shruarjes së asfalt-betoni me cilindra është përvetësuar mënyra e nxehtë e realizimit, d.m.th e përfitimit (përzierjes) dhe shtruarjes, prandaj gjatë këij procesi duhet që:

- Temperaturat e rekomanduara të deponimit të bitumenit në stabilimentin e asfaltit, varësisht nga lloji i bitumenit për rrugë, duhet të jetë $130^0$C deri rreth $170^0$C;
- Temperaturat e rekomanduara të përzierjës së bazes se asfaltit në dalje nga përzierja e stabilimentit të asfaltit, varësisht nga lloji I bitumenti për rrugë, duhet të jetë prej $130^0$C deri $180^0$C;
- Temperaturat e rekomanduara të përzierjës së bazes se asfaltit në vendin ku bëhet shtruarja, varësisht nga lloji i bitumenit për rrugë, duhet të jetë prej $130^0$C deri rreth $170^0$C, respektivisht jo më e ulët se $110^0$C.

Baza e procesit teknologjik të bazes se asfaltit betonit në kuptim të gjerë është përzierja e masës së asfaltit dhe shtruarja e masës së përziër të asfaltit. Prandaj realizimi i shtruarjes së asfalt-betonit nënkupton prodhimin e përzierjës së asfaltit në impiantin (stabilimentet) e asfaltit të cilat në praktikë janë të emërtuara si baza të asfaltit. Baza e asfaltit është një sistem kompleks makinerik që ka për qëllim prodhimin kualitativ të përzierjës së ngrohtë të asfalt betonit me përmbajtje dhe temperaturë të dhënë në dalje. Operacionet dhe veprimet bazë teknologjike të prodhimit të përzierjës së ngrohtë të asfaltit betonit janë:

Deponimi i përbërsëve (fraksionet e gurit, mielli i gurit-mbushësi, bitumenit) dozimi i tyre d.m.th maja (me peshore automatike ose me prurje), ngrohja dhe përzierja dhe deponimi i përkoshëm i përzierjës se ngorhtë të asfaltit. Shënimet teknologjike dhe konstruktive të bazës së asfaltit e përcaktojnë mënyrën e realizimit, respektivisht vec e vec përzierjën e masës së asfaltit i cili në këtë kontest mund të jetë i dyfishtë: ciklik dhe kontinual. Shikuar ne përgjithësi forma ciklike e realizimit të përzierjes së ngrohte të asfaltit-betonit është më kualitativ se sa ai kontinual veçanarisht për arsye të matjes më të saktë të përberësëve me peshore, për ndryshim nga ai kontinual tek i cili agregatet sipas prurjes dozohen pandërprerë.




**Figura 13.** Impianti i bazës se asfaltit

### *4.4.* Procesi teknologjik i bazës së asfaltit me veprim ciklik

Bazat e zakonshme me mënyren ciklile të përzierjes (standarde dhe kushtimisht “klasike”) gjatë punës përzierëset mbushen, pastaj përzihen dhe zbrasin në intervale të njëjta kohore përbërjën e masës së bazes se asfaltit në pajtim me perimetrin e tamburit të përziersës. Do të thot se vetë operacioni i formimit të përzierjes së bazes  asfaltit është cikle, sepse kemi përzierje ciklike. Megjithëse duhet përmendur që pjesa tjetër e stabilimenteve të asfaltit, përveq përziersës dhe tërësisë transportuese për nevojat e deponimit të përzierjes së ngrohtë të asfaltit-betonit, nëprincip punojnënë mënyrë kontinuale deri te silosi për agregat para vetë përzierjës ciklike.

Ky lloj i bazave të asfaltit akoma është më e shpeshta në përdorim për nevojat e shtruarjes së asfalt-betonit të ngrohtë. Zakonisht kapaciteti i tyre prodhues është mesatar deri te ai i lartë (si shembull programi prodhuës i një fabrike të stabilimenteve përfshinë kapacitetet e instaluara: 35 deri 50 t/orë, 50 deri 90 t/orë, 90 deri 160 t/orë, 160 deri 250 t/orë dhe 250 deri 310 t/orë ). Të gjithakëto stabilimente, qofshin ato (gjysmë) të lëvizëshme ose që bartën lehtë ose të përherëshme d.m.th të pa lëvizëshme, përfshijnë terësi të lloj-llojëshme makinerike, pajisje dhe prodhuëse-teknologjik (ne fig. Vërehen nënterësitë teknologjike të bazës së asfalt-betonit me mënyrë të punës ciklike):

- Terësia e shumë bunkerëve në formë të siloseve të hapura për deponimin e agregatit me dhënësit “prurorë” të dozimit paraprak të fraksionëve të ndryshëme të gurit duke I pëfshirë edhe shiritat transportuës prej bunkerit derite përzierësja.



**Figura 14.** Skema parimore e bazës së asfaltit me veprim ciklik

1. Furnizimi me lëndë gurore dhe dozatorët;
2. Tamburi tharës;
3. Filtri për depluhurim;
4. Elevatori me kova;
5. Sita;
6. Silosët e agregatëve;
7. Pëshoret për matjen e materialit guror, filerit, bitumenit dhe aditivëve;
8. Mikseri;
9. Bunkeri lëvizës, për hedhje të lirë;
10. Silosët për përzierjen e nxehtë;
11. Zbrasja ne kamionin transportuës;

12. Silosi i filterit;
13. Rezervuarët dhe instalimi elektrik për ngrohjen bitumenit;
14. Kabina komanduese.

- Tamburi rrotulluës për tharje të agregatit (ngrohja dhe depluhurimi) pjerrtësuar pak, nëse shfrytëzohet nafta ose gazi si lëndë djegëse atëherë në kuadër të kësaj nëntërsie gjendën një ose me shumë cisterna (rezervuare) me pajisjen për furnizim me lëndë djegëse deri te brineri I tamburit.



**Figura 15.** Tamburi rrotulluës për tharje të agregatit

- Terësia e pajisjëve të filtrave (seperatorëve) për ndarjen e mbushësit (filteri) nga pluhuri të fituar nga depluhurimi i agregatit në tamburin për tharje, bashkë me pajisjen për depluhurim d.m.th nxjerrja dhe transporti I pluhurit deri te ciklonet dhe filtrate të cilët i përbejnë tubacionet e posaçerisht dhe ventilator, të cilët e thithin pluhurin nga tambura nepër filtra ne kuadër të kësaj nënterësie teknologjike gjendën një orë ose me shumë silose vertikale të mbyllura për deponimin e filterit nga depluhurizimi jashtë mbushjës së përgatitur bashkë me paisjën për transport të mbushjes deri te përziersja (mikseri).
- Terësia e paisjes për deponimin e përzierjës së gatshme të asfalt-betonit me skip-paisje (transporteri i pjerrët (siloset) e mbyllur (që t'i ketë transmetimit të jashtëm të

nxehtësisë janë të izuluar) e vendosur gjithashtu në kuadër të tërësisë së konstruksionit të veçantë në të cilën mund të vijë kamioni për ta pranuar dhe bërë transportin e metutjeshëm të masës së asfalt-betonit deri të vendi I shtruarjes (vendpunishtja).

- Deponitë respektivisht rezervuarët, kaldajat e bitumenit dhe bazes së asfaltit duke përfshi edhe paisjen për nxehje respektivisht shkrirje të elementit lidhës si dhe paisjet tjera (pompat, tubacionet për transport të elementit lidhës e deri të përzierësja).
- Terësia e paisjes së elektro-repartit dhe instalimi i stabilimentit duke përfshirë të ashtuquajturën “shtëpizën komanduese me paisje dhe pajime për dirigjimin e punës së stabilimentit në mënyrë kompjuterike. Pjesët kryesore të bazës së asfaltit më mënyrë ciklike të punës të cilat njekohësisht I takojnë procesit teknologjik dhe operacioneve të plota të mënyrës së prodhimit të përzierjës së asfalt-betonit dhe të cilat përcaktojnë kapacitetin e tij të mundëshëm, do të jenë: tambura për tharjen e agregatit, (ku temperatuar e lartë e agregatit në dalje është në mes të 150 deri 170 e me së shumti deri në 220 $^{0}$C arrihet me anë të flakësqë pason nga djegia e vajit termal me vërejtjen se sot gjithënjë e më shumë për shkaqe ekologjike si lëndë djegëse shfrytëzohen lëndët e gazëta, sita për sitjen e agregatit të nxehtë dhe përziersja e përberësve të masës së asfaltit.




**Figura 16.** Procesi i tharjes

Në tamburin për tharje (fig.4) kryhet ngrohja dhe depluhurimi i agregatit të ngrohur në mënyrë qe të “tërhiqën” e gjitha grimcat e pluhurit qoftë ne përberje të gurit ose argjilës. Ky pluhur më tej përcillet në ciklone dhe filtra ku me proces të thatë apo të lagësht pluhuri i gurit largohet prej pluhurit të argjilës. Në këtë mënyrë ndarja e pluhurit të gurit përseri kthehet si mbushës së procesin e prodhimit të përzierjës se asfalt-betonit.

Duhet theksuar që tamburi për tharje të agregatit punon në “principin e rrymimit”prandaj queht edhe si tambur me rrymim të kundërt të tharjes së agregatit. Te ky masa e flakës së nxehtë rrymon në një kahje ndërsa agregati në tambur rrotullohet poshtë në kahjen e kundert. Me këtë rast vetëm depluhurimi kryhet në pjesën më të lartë të tamburit d.m.th në fillim të tamburit ku futet agregati dhe ku temperaturat e masës së flakës janë më të ulëta. Me rastin e nxemjës dhe depluhurimit, rëra e gurit pjesërisht shkapërderdhet dhe me këtë rast e humbë një pjesë të masës së saj, mirëpo kjo masë plotësohet me përberjën e tij granulometrike me të cilat ka “ardhë” ne tambur për tharje. Për këtë qëllim agregati “shkon” më tutje në sitjen e mëtejme të nxehtë. Këtu përmirësohet përmbajtja granulometrike e fraksioneve të veqanta të agregatit dhe me këtë harmonizohet me matje të mëtutjeshme para përzierjës me përbërje të dhënë, i cili është e paraparë me recepturë të përzierjës së nxehtë të asfalt-betonit.

### 4.5. Karakteristikat teknike – Specifikacioni i pajisjeve

Tipi i impiantit: W KM 200 – 5

Prodhuesi – Ammann-Wibau, Gjermani

Kapaciteti nominal i impiantit: Q= 240 t/h, i cili është i bazuar në :

- Lagështinë fillestre të minerslit (materialit guror) 5%
- Lagështia përfundimtare të mineralit-më e ulët se 0.5%
- Ngritjen e teperaturës për 180$^0$C
- Dendësia e mineralit 1.8t/m$^3$
- Përmajtjen e materialit lidhës 6%
- Fuqinë e instaluar 400 kW

**4.6. Paisjet për dozim**

Aparati për dozim  i tipit: DG 4/3

| | |
|---|---|
| Lloji | dozuës njësh |
| Lloji i dozimit | nëmasë |
| Kapaciteti i dozimit | 40t/h për një dozator |

Rregullohet në 4 etapa

1. Etapa 1 deri   8 t/h
2. Etapa 2  deri  15.5 t/h
3. Etapa 3   deri  23.5 t/h
4. Etapa 4   deri  45  t/h

-Shiritat transportues përmbledhës

| | |
|---|---|
| - Gjerësia e shiritit | B=650 mm |
| - Gjatësia e shiritit | L=27 000 mm=27m |
| - Këndi i pjerrtësisë së transporterit: | $\boldsymbol{\beta}_p=0^0$ |
| -Fuqia e elektromotorit | P=5kË |
| -Numri i rrotullimeve | $n_0$=1420 rr/min |
| -Shpejtësia | v=1.3 m/s |
| -Kapaciteti maksimal: | $Q_{max}=3600\ A\ v\ k_m\ k_p(m^3/h)$ |

$Q_{max} = 3600\ Av\ k_m\ k_p=3600x0.0657x1.3x0.8x1=246\ (m^3/h)$

-Pesha specifike e materialit mbushës: $\boldsymbol{\gamma}$ =1.8 t/$m^3$

-Gjerësia active e shiritit: b1=B-0.05=645 mm = 0.645m

-Këndi mbushës : $\varphi = 15^0$

-Seksioni tërthor i mbushjes : U (me tre rula)




**Figura 17.** Seksioni në formë U me togun me tre rula të vëndosur nën këndin e pjerrtësisë $\lambda=20^0$

- Shiriti transportuës furnizuës;
- Tamburi për tharje i tipit: TT 5/2;
- Kaldatorja dhe rezervuari i vajit për ngrohje (mazutit);
- Transpoteri çikrik (me kova);
- Kutia e komandës hidraulike;
- Kulla përzierse.

a) Sita

Konstruksioni me 5 shtresa të ndara të sitës për fraksionet: 0-2 mm, 2-4 mm, 4-8 mm, 8-11 mm, 11-16, mm 16-22 mm, 22-31.5 si dhe filtrimi i kokërrzave tepricë.

Elektromotori: P = 7.5 Kë

Sipërfaqja totale e sitës: 12 $m^2$

b) Bunkerët e sitës

| | |
|---|---|
| Bunkerët me kapacitet | 100 t |

4 vibratorë P = 4 x 7.5 Kë

c) Përziersja (mikseri):

| | |
|---|---|
| Prodhuesi: | Ammann-Wibau |
| Kapaciteti nominal i përzierjës: | 240 t/h për 80 ngarkesa në orë |
| Lloji: përzierse (mikser) me dy boshte | 3000 kg/për ngarkesë |
| Elektromotori: | P = 75 Kë |

Peshorja për materialin guror:

Lloji: peshore ngrutëse me trehues me mbushje max.

Dhe matës largësie

| | |
|---|---|
| Kapaciteti: | 250 kg |

Dozimi i materialit lidhës (bitumenit):

| | |
|---|---|
| Lloji: | Peshore ngritëse |
| Kapaciteti: | 80 T-RPP 630-LN-S |
| Elektromotori | n = 400 rr/min |
| | P = 7.5 Kë |

d) Siloset e materialit të gatshëm për ngarkim:

Siloset për ngarkim të ndarë në tri pjesë: 1 x10 t, 1x100 t, 1 x 100 t

| | |
|---|---|
| - Kapaciteti I tërë: | 210 t |
| Kapaku nxehët në mënyrë elektrike | 4 x 9.6 Kë |

e) Filteri:

Tipi:

| | |
|---|---|
| Numri i ciklonëve | 4 |
| Përmasa e ciklonëve | 1304 mm |
| Elektromotori i ventilatorit të gazrave | P = 110 Kë |
| Kapaciteti maksimal | 50000 $m^3$/h (bazuar në 150 $^0$C) |
| Lartësia e oxhakut | L = 23 m |
| Diametri i oxhakut | D = 1200 mm |
| Riciklimi i filterit | |
| Tranporteri kërmillor | |
| Elektromotori | P = 2.2 kW |
| Elektromotori i pompës për filtrim | P = 0.55 kW |
| Transporteri kërmillor për bartje të pjerrtë | |
| Elektromotori | P = 5.5 kW |
| Elevatori | P = 3.0 kW |

f) Furnizimi me filter shtesë:

| | |
|---|---|
| Transpoteri kërmillor për bartje të pjerrtë | P = 5.5 kW |



**Figura 18.** Procesi teknologjik i fabrikës

Lëgjenda e skemës teknologjike:

1. Materiali guror i papërpunuar dhe paradozimi

- Deponia e materialit guror (zhavori, rëra, guri i thërmuar)
- Ngarkuësi
- Fortinat e materialit guror (gjithësej 8 fortina) dhe paijes dozuese
- Shiritat transformuës.




**Figura 19.** Fortina dhe pajisjet për dozim

2. Tharja e materialit, nxehja dhe largimi i pluhurit
- Tamburi tharës
- Brineri





**Figura 21.** Transporteri furnizuës i tamburit tharës

3. Pajisja për depluhurim

- Ndalësi i pluhurit të trashë
- Filteri pastruës
- Ventilatori droselues
- Oxhaku
- Transporterët kërmillor




**Figura 20.** Filteri për depluhurim



**Figura 21.** Pamje nga prerja e filterit për depluhurim

4. Kulla përzierëse

- Elevatori me kova për bartjen e materialit të nxehtë

- Sita vibruëse
- Silosët e materialit guror
- Peshorja e materialit guror
- Peshorja e filterit
- Peshorja e bitumenit
- Përziersja (mikseri)
- Korpa shkarkuëse
- Ventilator për thithjen e pluhurit dhe tymit nga kulla përzierse
- Gypi për pastrimin e kullës përzierse
- Pajisja për furnizim me ajër të shtypur



**Figura 22.** Kulla e përzierjës




**Figura 23.** Peshorja dhe pajisja për përzierje të bitumenit

5. Siloset e materialit të gatshëm

- Traseja për lëvizjen e korpës shkarkuëse
- Materiali i gatshëm
- Peshorja e ngarkesës



**Figura 24.** Sistemi i furnizimit me material guror dhe dozimit

6. Pjisjet për furnizim me filtër

- Silosi i filterit për prodhuar
- Silosi i filterit të importuar
- Elevator i filterit
- Transportuesi kërmillor
- Furnizimi me filter të importuar
- Filtrate e silosëve të filtrit

7. Pajisjet për furnizim me bitumen

- Rezërvuaret e bitumenit, 440 $m^3$
- Rrjeti gypor për furnizim me bitumen
- Pompat e bitumenit




**Figura 25.** Sistemi i furnizimit me filter



**Figura 26.** Rezërvuaret e bitumenit i ndërtuar nga celiku St 37 me mure të dyfishta izuluar me lesh guri dhe i mveshur me llamarinë zinku



**Figura 27.** Elevatori me kova

8. Rezërvuari i vajit termal
- Rezervuaret e vajot termal
9. Kaldaja e vajit termal, ndezësi i vajit termal, P = 550 Kw
- Pompa për furnizim
- Rrjeti gypor



**Figura 28.** Qendra komanduese, elektrike, dirigjuese



**Figura 29.** Sita



**Figura 32**. Sillosi i fraksioneve të nxehta



**Figura 33.** Matja dhe përzierja e bitumenit



**Figura 34.** Silosët për materialin e gatshëm



**Figura 35.** Paneli komandues

### *4.7.* Procesi i përfitimit të asfaltit

Gjatë prodhimit të bazes  asfaltit nga llojet e ndryshme të masave tek të cilat përdoret si element lidhës i agregatit të ngurtë lidhjet hidrokarbure të cilat kanë ngjitje të mirë athezione me materialnin guror. Këto lidhje janë hidrofobie d,m,th, e largojnë ujin, pastaj janë plastike dhe për këtë arsye janë të rezisuëshme ndaj veprimit të atmosferës dhe kemikaleve të ndryshme.

Kostruksionet rrugore të shtresave të lidhura të bazes  asfaltit realizohen sipas shtresave ne vazhdim:

- Shtesa e poshtme bartëse e bitumenizuar (në praktikë emërohet bito zhavor) me madhësi të kokërrizës së agregatit deri 32 mm ose deri me 45 mm apo 64 mm rarësisht nga tipi dhe trashësia e shtresës;
- Shtesa e epërme bartëse e bituminizuar (në praktikë emërohet bito zhavor) me madhësi të kokërrzës së agregatit deri 32 mm ose deri ne 45 mm apo 64 mm varësisht nga tipi dhe trashësia;
- Shtresa konsumuëse prej asfaltit betony AB me madhësi të kokërrizëz së agregatit
    - Deri në 8 mm (AB 4) për trashësinë teknologjike të realizuar të shtresës prej 20 deri 30 mm;

- Deri në 11 mm (AB 8) për trashësinë teknologjike të realizuar të shtresës prej 30 deri 40 mm;
- Deri në 16 mm (AB 11) për trashësinë teknologjike të realizuar të shtresës prej 35 deri 50 mm;
- Deri në 22 mm (AB 16) për trashësinë teknologjike të realizuar të shtresës prej 45 deri 60 mm;
- Deri në 8 mm (AB 32) për trashësinë teknologjike të realizuar të shtresës prej 70 deri 85 mm.

Shtresat konsumuëse bashkëkohore realizohen në formë të ashtuquajturës splimmastiks asfalt (SMA) respektivisht një lloj i vecantë i masës së asfaltit me gur të thërmuar shumë kualitativ, bitumeni më kualitativ dhe asfalt natyral si lidhës.

### 4.8. Karakteristikat përberëse të lëndës së parë

Masat e asfaltit është kombinim i tre përberësve themelorë:

- Hidrokarbureve si element lidhës (bitumen)
- Miellit të gurit respektivisht pluhuri I gurit – filerit, madhësia maksimale e kokërrzës është 0.25 mm, përjashtimisht 0.71 mm ku sasia më e madhe 60- 85 % e përberjës granulometrike të pluhurit e përbenë e ashtuquajtura, diametric I grimcave më të vogla se 0.063 dhe
- Përberësit mineral d.m.th rëra e gurit (rëra natyrale e situr apo e pa situr, ose i bluar i situr apo i pa situr).

Masën e përzierjës së asfaltit e përbëjnë 92 – 97 % prodhimet në vazhdim:

- Zhavori natyral i pa thërmuar i situr apo i pa situr
- Zhavori natyral i thërmuar dhe i situr
- Gurët e thërmuar dhë të situr të fituar pej shkëmbit të minuar
- Përzierja e bluar (paraprakisht e minuar) dhe materialit të gurit (rërës, zhavorit) të situr apo të pa situr.

# 5. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT

## 6.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për zvogëlimin ndotjes se ajrit nga fabrika për prodhimin e bazes se asfaltit për ndërtimin e rrugëve “Bllok Group” sh.p.k duhet qe te mirëmbaje ne mënyrë te vazhdueshme hapsira prodhuese brenda dhe jashtë objekteve. Lendes se pare per prodhimin e asfaltit, duhet te i kushtohet rëndësi e veçantë po ashtu edhe pajisjeve mekanike qe përdoren gjate procesit te prodhimit të produktëve ne fjalë, pajisjeve meotorrike-levizese qe te mos të lirojnë gazra e me këtë te ndotet ajri mirëpo ato te mirëmbahen ne mënyrë te rregullt dhe të mos ketë tejkalime vlerash të shkarkimit të gazrave gjatë djegies se lëndës për djegie. Mirëpo nga procesi i prodhimit një ndotje e ajrit mund te vije nga procesi i punës si pasojë e lëvizjes se makinërive që shfrytëzohet për transport. edhe e pastrimit të paisjeve-linjes së prodhimit, mirëpo cdo herë duhet t’i kushtohet një rendësi.

Për kufizimin e emetimeve të pluhurit ne njesië e prodhimit të asfaltit duhet të përdoren këto:

- Ujë për lagështiumin e grumbujve të agregatëve
- Ujë i ricikluar për larjen e automjetëve të rënda për transportin, i cili do të vijë nga rezervuari i mbetjeve të ngjashme,
- Larja e automjetëve do të bëhet në dyshemenë e çimentuar me gradient dhe balotazhi do të çohet në një rezervuar sendimentimi.
- Sistemet kontrollit të ndotjës të tilla si filtrate e rrobave ose një sistem tjetër i përformancës ekuivalente në policë, ekranet, biën misdis transportuësve, silosave.
- Sistemi i automatizuar i lagështimit.

Për minimizimin e tymit, propozohen këto:

- Mirëmbajtja e shpeshtë dhe periodike e të gjithë makinerive ndërtimore nga personeli i specializuar.
- Ndalimi i zjarrëve në sipërfaqe të hapura

Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit në bazën e asfa1tit e cila ndodhë si produkt i djegies së vajrave ndezëse ose naftës, është e nevojshme të sigurohen kushtet për djegie sa më kualitative, si dhe mirëmbajtjen dhe servisimin e rregullt të ndezësit. Prandaj nëse përpjesëtimi i ajrit dhe lëndës djegëse është optimal atëherë në atmosferë lirohen gazrat pa blozë të dukshme.

Gjatë tharjes dhe nxehjes të fraksioneve të gurit gëlqeror ose mineraleve tjera emitohen sasia të mëdha të pluhurit mineral dhe gazrat ndotëse. Në bazën e asfaltit praktikisht do të jetë e pamundur të punohet dhe kjo ndotje e ajrit në mjedisin punues dhe rrethues nuk është ligjërisht e lejuar, për këtë është dashur të sigurohen pajimet adekuate të filtrimit për ndarjen e pluhurit nga rrymimi i gazrave me qëllim të parandalimit ose zvogëlimit të emetimeve ne atmosferë në përputhshmëri me kërkesat e legjislacionit vendor. Njëkohësisht pluhurin e ndarë do të jetë e mundur ta rikthejmë në prodhim të asfaltit si filer. Me projektin teknologjik janë përcaktuar filterët më thasë dhe atë janë të vendosur filtra, të cilët i përkasin kategorisë mjaft efikase për frajtimin e gazrave gjegjësisht ndarjen e pluhurit nga to, pluhuri mineral i prodhuar bashku me gazrat tymues të nxehtë dërgohet për mes gyp sjellësve në precipitues, pastaj përmes filtrimit me thasë në tymtar,nga i cili gazrat tymues të pastruar (trajtuar) lëshohen në atmosferë, në precipitues ndahen grimcat e pluhurit me madhësi ne milimikron, të cilët përmes transpoffierit kërmillor dhe elevatorit kthehen në procesin e prodhimit, në filterët me thasë ndahet pluhuri i mbetur i cili me transportier kërmillor dërgohet në pajimet për deponim dhe matje të filerit.

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimëve negative ne ajër gjatë procesit teknologjik të fabrikës se asfaltit përpos masave të lartëcekur duhet të ndërmerrën edhe këto masa:

- Duhet të bëhët mirëmbajtja e rregullt e pajimëve për prodhim të asfaltit e posaçerisht stabilimentëve të cilat janë burim I emisionëve të pluhurit.
- Duhet të bëhët mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvoglimin e oluhurit me filtër.
- Duhet të bëhët kontrollimi i rregullt I thasëve filtruës të dëmtuarit të ndërrohën.
- Duhet të bëhët kontrollimi I rregullt teknik i automjetëve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim qe lirimi I gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.

- Gjithmonë duhet të behet spërkatja e sipërfaqëve manipuluese, rrugëve transportuese, fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta

- Duhet çdo herë të ketë ujë rezervë për spërkatje.

- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, ne kohëra të thata edhe të spërkaten me ujë.

Në kushtet e udhëheqjes së procesit teknologjik sipas normave të projektuara dhe me kontroll të mirëfilltë të pajisjeve për filtrim nuk ekziston rreziku qö ndolja e ajrit të jetë mbi vlerat maksimale të lejuara të materieve ndotëse të caktuara si pas Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme te ndotjes dhe normave të caktıiara nga legjislacioni vendor dhe i BE. Kompania duhet te bëjë vendosjen e pajimeve për matjen pluhurit dhe gazrave (që lirohen gjatë punës së bazës së asfaltit pas lëshimit ne punë të bazës së asfaltit me objektet përcjellëse do të bej matjen e cilësisë të ajrit, vlerat e fituara do të krahasohen dhe nuk duhet të jenë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhözimit Administrativ Nr, 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes dhe normave të caktuara nga legjislacioni vendor dhe i BE. Vlerat e fituara ne bazë të maljeve duhet të dorëzohen ne MMPHI, intervali i matjeve do të kryhet ne bazë të përcaktimit me aktet ligjore dhe ne bazë të marrëveshjes me MMPHI.

### 5.2. Masat per mbrojtje nga ndikimet e zhurmes

Masat kryesore zbutëse për të zvogëluar zhutmën, si (dhe nivelet e dridhjeve gjatë operimit janë këto:

- Të gjitha automjetet dhe makineritë e përdorura në vendet e ndërtimit do t'i nënshtrohen mirëmbajtjes së rregullt. Automjetet dhe makinat që janë tepër të zhurmshme për shkak të rregullimit të dobët të motorit ose pajisjeve të kontrollit të zhurmës nuk duhet të funksionojnë derisa të jenë zbatuar masat korrigjuese.
- Kur është e mundur, të gjitha pajisjet e ndërtimit do të jenë në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE 2000/14 / EC për emetimin e zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim jashtë (ekziston mungesa e legjislacionit kombëtar për nivelet e zhurmës së emetimit të pajisjeve në natyrë). Të gjitha pajisjet duhet të kenë shënimin CE

dhe treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së shëndoshë dhe shoqërohen me një deklaratë të konformitetit të KE.

- Pajisjet do të pajisen me pajisje të përshtatshme për zhurmë zhurmës që do të zvogëlojnë nivelet e zërit.
- Çdo përpjekje do të bëhet per të përmbushur kufijtë e zhurmës së korrespondentit për secilën zonë ku do të zhvillohen punimet e ndërtimit.
- Punimet e ndërtimit nuk do të lejohen gjatë natës; operacionet në vend do të kufizohen në orët 07.00 -19.00 h;
- Banorët e prekur lokalë do të informohen, në maksimumt për përpjekjet e projektit, në kohën e duhur të punimeve të planifikuara, nivelet e dridhjeve dhe zhurmës dhe orët e ditës gjatë së cilës ato do të ndodhin.
- Në rastin kur punimet e zhurmshme duhet të kryhen natën ose gjatë një periudhe më të gjatë se një ditë në një vend të caktuar, do të ngrihet një pengesë e zhurmës rreth zonës së punës.
- Aktivitete të tilla si prishja, funksionimi i tokës dhe ndikimi në tokë do të planifikohen në mënyrë që të mos ndodhin në të njëjtën kohä Për dalli-m nga zhurma, niveli i përgjithshëm i dridhjeve të prodhuara mund të jetë dukshëm më i vogël kur secili burim dridhjeje vepron veçmas;

Ne fazën efunksionimit - Duhet të bëhen mauet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti' krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në rast se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të prodhimit duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

### 5.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

pse ne procesin pör prodhimin asfaltit nuk lirohen ujera të ndotura teknologjike, por ndotja ndodhë si që e kemi përshkruar mësipërme, ne hapësirat punuese të bazës së asfaltit, prandaj duhet ndërtuar kolektorët për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen punuese te ofiçinës së mirëmbajtjes dhe kanalit të ndërrimit të vajrave, nga sipërfaqet ku janë të vendosur

rezervarët e lëndëve djegëse (mazutit, naftës), bitumenit, nga sipërfaqet ku është i vendosur gjeneratori, stacioni i pompave, kaldajat, nga sipörfaqet e depos së vajrave dhe lubrifikanteve, ujerat e grumbulluar nga sipërfaqet e lartëcekura duhet të dërgohen për trajtim në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta dhe me vajra e yndyra të ndryshme.

Separatori duhet ndërtuar sipas standardeve dine ne bazë të përmasave cihe përshkrimit të dhenura ne projektin kryesor të ndërtimit të bazës së asfaltit për ndërtimin e seperatorit të vajrave, Seperatori duhet në mënyrë të sigurtë cihe kualitative të bejë ndarjen (seperimin) e yndyrave dhe vajrave nga ujörat e ndotura, duhet ndërtuar me kapacitet të trajtimit të ujörave, Seperatori i vajrave duhet të bëjë ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon ne pesetën e posaçme, ku pas mbushjes së pesetës duhet të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorve dhe gropave septike. Seperatori duhet të përmbush kriteret teknike që janë te parapara me rregullore dhe normative ne fuqi. Seperatori duhet të rregullohet në atë mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht ne mënyrë vizuale uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet.

Përpos sistemit të gypave duhet të ndërtohet edhe sistemi i kanalit rreth e përqark bazës se asfaltit për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura gjerë në puset sedimentuese, puset sedimentuese duhet të ndërtohen tri puse për sedimentimin e thërrmijave të ngurta. Pas trajtimit në puset sedimentuse uji orientohet për trajtim të mëtutjeshëm në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e trajtuara në seperator të lëshohen në recipient. Duhet rregullisht të pastrohen puset sedimentuese dhe seperatori. Ujërat zeza duhet së pari te trajtohen në gropën septike e cila duhet ndërtuar me tri komora (hapësira). Gropa septike duhet të ndërtohet në at mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe mostrimin të ujërave të ndotura që shkarkohen në recipient, para Iëshuarjes së ujërave ne recipient duhet patjetër të dezinfektohen me natrium hipoklorit për mes klorinatorit që duhet ndërtuar. Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara.

Ujërat nga separatori dhe gropa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi Img/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.

Ujërat nga separatorët dhe gropa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi vlerat e përcaktuara me Udhëzim administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet ne trup ujorë dhe ne rrjetin e kanalizimit publik.

Po ashtu edhe ujerat fekale kompania planifikon te i shkarkoj ne rrjetin e kanalizimit te qytetit, pasi qe ky rrjete është i shtrire deri ne afërsi te parcelës ku ndërtohet impianti.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit të bazës së asfaltit duhet të merren këto masa:

Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha Ilojeve të mbeturinave të klasifikuara ne bazë te rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese që nevojitën për ndërtimin e kompleksit të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë , vajrat duhet të deponohen në enë të posaçme dhe pastaj të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së operimit të bazës së asfaltit dilhet të merren këto masa:

- Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative te tëra hapësirat punuese ne të cilat bëhet manipulimi me karburante duhet të mbulohen me beton.
- Tëra sipërfaqet ku janë të vendosur gjeneratori, stacioni i pompave, kaldajat, deponimi i vajrave dhe lubrifikanteve duhet të mbulohen me beton.
- Rezervarët statik te lëndëve djegëse dhe bitumenit duhet të vendosen në hapësirat e betonuara dhe duhet të rrethohen me mur stafk prej betoni, largësia e murit nga rezervarët dhe lartësia e murit duhet ndërtuar ne mënyrë që ta nzan ter sasinë e karburantit.
